



Planuar / Dërguar Primiprenut / Pradato Received / Delivered	04.02.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtet / Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPSHTOK	547/2022		11



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1151/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-Kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushti Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, shqyrtojë ankesën e dhe të bashkuara me ankesën A.nr.1151/2021, sipas Vendimit VK.nr.09/2022 të datës 24.01.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 të Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për miratimin e Rregullores Nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Pagave të nëpunësve të Agjencisë, dhe duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën e mbajtur me datë 04.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura lidhur me ankesën A.nr.1151/2021 të bashkuar sipas Vendimit VK.nr.09/2022 të datës 24.01.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

A r s y e t i m

dhe nëpunës civil në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 të Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për miratimin e Rregullores Nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Pagave të nëpunësve të Agjencisë, me kërkesë për anulimin e të njëjtit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesve bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë, me datë 24.01.2022 ka nxjerr Vendimin VK.nr.09/2022 përmes të cilit ka bashkuar ankesat e ankuesve dhe pas bashkimit ankesa ka marr numrin A.nr.1151/2021.

Departamenti i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes emailit zyrtar të datës 03.02.2022, ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me Aktgjykimin C-IV-21-0231 të datës 01.02.2022 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përmes të cilit aktgjykim gjykata ka hedhur poshtë si të pa themeltë padinë/kërkesë padinë e përbashkët të ankuesve me të cilën kanë kërkuar anulimin e Vendimit të Bordit të Drejtoreshave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit Nr.Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 lidhur me zbatimin e Rregullores Nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Pagave të nëpunësve të Agjencisë, si dhe Propozimin për masën e sigurisë me të cilin do t'i ndalohej të paditurës që të mos bëjë ulje të pagave deri në vendosjen e çështjes me vendim përfundimtar nga gjykata.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke marr parasysh se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin C-IV-21-0231 të datës 01.02.2022 ka konstatuar se kërkesa/padia me kërkesë padi është e pranueshme për procedim në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, por e pathemeltë, dhe meqenëse Aktgjykimi C-IV-21-0231 i datës 01.02.2022 nuk është përfundimtar sepse kundër të njëjtit lejohet e drejta e ankesës brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit, Kolegji në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit"*, si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për *pezullim të procedurës në lidhje me ankesën A.nr.1151/2021.*

Procedura lidhur me ankesën A.nr.1151/2021 të bashkuar sipas Vendimit VK.nr.09/2022 të datës 24.01.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, do të mbetet e pezulluar deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështjes në gjykatën kompetente.

Duke u bazuar si me lartë, dhe në mbështetje të nenit nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1151/2021


Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës


Ardita Haxhiukaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve;
- Drejtorit Menaxhues të AKP-së;
- Departamentit për Burime Njerëzore në AKP; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

